

LIGJI Nr. 03/L-002

PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E KODIT TË PËRKOHSHËM PENAL TË KOSOVËS

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Me qëllim të krijimit të kushteve më të favorshme dhe shtimin e efikasitetit të punës në Gjykata dhe Prokurori në Kosovë, në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare,

Miraton

LIGJ PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E KODIT TË PËRKOHSHËM PENAL TË KOSOVËS

Neni 1

Në titullin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës dhe në tërë tekstin e këtij kodi fjalia Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës zëvendësohet me fjalinë Kodi Penal i Kosovës.

Neni 2

Neni 66 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, plotësohet me një paragraf të ri si në vijim:

3) Kur kryesi të ketë pranuar fajësinë në përputhje me kushtet e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë të pranuar nga gjykata bazuar në nenin 6, (lidhur me nenin 308 A paragrafi 12) të Ligjit nr. 03/L-003 për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës nr. 2003/26 dhe marrëveshja mbi pranimin e fajësisë në formë të shkruar përmban klauzolën me të cilën parasheh zbutjen e dënimit, gjykata do të shqiptojë një dënim më të butë. Në rast të tillë, gjykata duhet të merr parasysht vështrimet e prokurorit, mbrojtësit, të akuzuarit dhe palës së dëmtuar sa i përket zbutjes së dënimit, dhe do të udhëzohet por jo detyrohet nga kufizimet e dhëna me nenin 67 të këtij Kodi.

Neni 3

Ky ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/ L-002
6 Nëntor 2008

Shpallur me dekretin Nr. DL- 059- 2008, datë 27.11.2008 nga Presidenti i Republikës së Kosovës,
Dr. Fatmir Sejdiu.